

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**, Departamenti i përgjithshëm, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Naser Maliqi me Sek. Juridike Zahide Rexhepi, e sipas padisë së paditësit **PTK- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, SH.A. - me seli ne Prishtinë**, e ndaj të paditurit **nga**, baza e kontestit pagesa e borxhit, e pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me date 21.11.2013 shpallë:

#### **AKTGJYKIM**

Aprovohet kërkesëpadia e paditësit PTK- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, SH.A. - me seli në Prishtinë, **obligohet i padituri** **nnga** që në emër të përmbushjes së borxhit për harxhimet telefonike, t'ia paguaj paditëses shumën prej 316.00 euro (treqindegjashtëmbëdhjetë euro) € si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 15 euro, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

#### **Arsyetim**

Përfaqësuesi i paditëses PTK, ka mbetur në tërsi pranë padisë dhe kërkesës, ka kërkuar që e njëjtë të aprovohet në tërsi.

I padituri  ka dekluaruar, qe borgji i cili figuron ne padi, nuk eshte e vërtet se eshte i tij, per shkak se e ka lajmruar drejtorin se e ka c'lajmruar telefonin ne marse te vitit 2003. Qlajrimin e ka bere me goje, nuk ka prova me shkrim. Me date 27.10.2005 e ka njoftuar PTK-ne se ky nuk eshte shpenzim i tij dhe se telefonin e ka te ndalur, mirpo nuk i jan përgjigjur me shkrim.

Ne procedurën e provave gjykata ka administruar-lexuar faturat 7/2003, sipas te cilës borgji eshte 2.50 euro, faturën 8/2003, sipas te cilës borgji i  per hargjime telefonike eshte 293,00 euro, sipas faturës nr. 9/2003 borgji eshte 18 euro, ndërsa sipas faturës nr. 10/2003 eshte 2 euro.

Shkresën e datës 27.10.2005, sipas te cilës  e ka njoftuar PTK-ne drejtorin e saje mbi disa ankesa qe ka patur lidhur me ngarkimin me disa hargjime, mirpo ne kete shkrese nuk ka asnji shenje se eshte dorzuar ne poste, datën dhe orën e dorzimit.

Ne fund te seancës përfaqësuesi i paditsit PTK, ka mbetur ne tersi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ka kërkuar qe e njëjtë te aprovohet si e bazuar.

I padituri e ka kundërshtuar ne tersi padinë dhe kërkesëpadinë e paditse, sepse borgji nuk eshte i tij, telefonin e ka patur te ckyqur prej marsit te viti 2003 e deri ne shkurt 2004.

Gjykata analizoi thenjete palve ndërgjyqës, provat e administruara veq e veq dhe ne tersi dhe konstatoi, se kërkesëpadia e paditsit eshte e bazuar, per shkak se nji gje e tille vërtetohet me faturat nr.7,8,9,10/2003, ne te cilat e hënët e hënët i ngarkuar me shpenzime telefonike, e te cilat shuma ne tersi perputhen me kërkesëpadinë e paditsit.

Sa i përket thenjeve te te paditurit se telefonin e ka patur te c;lajmruar qe nga marsi i viti 2003, gjykata nuk ka mundur ta vërtetoi me prova materiale, sepse i padituri vet ka deklaruar se posedon me te njëjtat. Ndërsa shkresa e datës 27.10.2005, me te cilën i eshte drejtuar te paditurës, nuk posedon asnji shenje-prove me te cilën do te vërtetohej dorzimi i saje ne PTK.

Per kete arsyе u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
Me 21.11.2013

Sek. Juridike:  
Zahide Rexhepi

Gjyqtari  
Naser Maliqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtronet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

